



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione**

P-nr.87/2024
Prishtinë, më 30.4.2024, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Arjeta Fejza, Albana Bytyçi, Nasuf Bejta, Labinotë Demi- Murtezi, Fatmire Kollçaku, Ariana Musliu- Shoshi, Eliza Hoxha dhe Marigona Geci.

Mungoi: Drita Millaku.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit dhe Sulltane Gashi, zyrtare e lartë në Komision.

Pjesëmarrës të tjerë: Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë; Ilir Morina, Prokuroria Speciale; Ardian Hajdari, Këshilli Prokurorial i Kosovës; Majlinda Shabani, GP LVV; Ema Krasniqi, KDI; Gent Ramosaj, GP AAK; Besarta Pllana, Kuvendi i Kosovës; Marigona Pajaziti, GP PDK; Arbnora Luta, ATV; Edina Avdiu, RTK; dhe Arjana Berisha- Kallxo.com.

Mbledhjen e kryesoi Duda Balje, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 16.4.2024;
3. Diskutim në Komision lidhur me çështjen e rritjes së numrit të prokurorëve që do të merren me krime të luftës dhe krime të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë;
Të ftuar: Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë dhe Ardian Hajdaraj, kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës.
4. Shqyrtimi i propozim-raportit me rekomandime lidhur me raportin vjetor të Institutit të Avokatit të Popullit për vitin 2022;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me datë 16.4.2024

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më datë 16 prill 2024, pa vërejtje.

3. Diskutim në Komision lidhur me çështjen e rritjes së numrit të prokurorëve që do të merren me krime të luftës dhe krime të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë; Të ftuar: Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë dhe Ardian Hajdaraj, kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Kryetarja, pasi njoftoi lidhur me diskutimin që do të jetë sot, fjalën ua dha të ftuarve.

Albulena Haxhiu, tha se prej se e ka marrë detyrën e ministres, është angazhuar në vazhdimësi lidhur me këtë çështje dhe një nga prioritetet e Ministrisë së Drejtësisë është edhe adresimi i krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit.

Njoftoi se tashmë ekziston Instituti për Dokumentimin dhe Hulumtimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, po ashtu me vendim të Kryeministrit Kurti, është zgjedhur edhe drejtori i këtij institucioni. Instituti është duke u përgatitur tani për rekrutimin e stafit, janë hapur edhe konkurset, me qëllim që të adresohet një prej përgjegjësave kryesore, që është hulumtimi, por edhe dokumentimi i krimeve të luftës, duke pasur parasysh se ende nuk kemi dokumentim institucional të të gjitha krimeve që Serbia i ka bërë në Kosovë. Jemi në prag të finalizimit të Strategjisë për drejtësinë tranzicionale, është një dokument tepër i rëndësishëm dhe po bëhet për herë të parë në Kosovë dhe që në thelb adreson kërkesat apo nevojat që i kanë viktimat e luftës.

Në vitin 2019, kur është bërë plotësim-ndryshimi i Kodit Penal, për gjykimin në mungesë, Prokuroria Speciale ka hasur në vështirësi të zbatimit të gjykimit në mungesë dhe pastaj kanë bërë ndryshimin, ku janë eliminuar disa prej pengesave që kanë qenë për këtë qëllim dhe ka filluar zbatimi i gjykimit në mungesë.

Duke pasur parasysh që Serbia nuk i dorëzon kriminelët e luftës, ka qenë jashtëzakonisht e rëndësishme që të ketë drejtësi për këto krime dhe për këtë tha se e vlerëson fillimin e zbatimit të kësaj dispozite.

Sa i përket rritjes së numrit të prokurorëve specialë, në qershor të vitit 2021, kanë rënë dakord me KPK-në, që numri i prokurorëve specialë në departamentin përkatës, të ngritët, për faktin se në atë kohë kanë qenë 4 dhe njëra nga prokuroret ka dalë në pension dhe si rrjedhojë, tashmë ky departament udhëhiqet nga prokurori Ilir Morina dhe është rënë dakord që mbi 100 mijë euro që kanë qenë të ndara për Ministrinë e Drejtësisë, të dedikohen për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me qëllim që KPK të rekrutojë edhe 5 prokurorë të tjerë në këtë departament, 6 bashkëpunëtorë profesionalë dhe dy staf tjetër mbështetës. Ky plotësim-ndryshim ka ndodhur edhe në Kuvendin e Kosovës, sepse Ministria e Drejtësisë nuk ka mundur ta bëjë këtë ndryshim, pa votim në Kuvend.

Por, që nga viti 2021, përkundër faktit që Ministria e Drejtësisë ka ndarë buxhetin për këtë qëllim, ende numri i këtij departamenti është shumë i vogël dhe me sa ka informacione numri i prokurorëve është vetëm 3. Më tej, theksoi se me të gjitha dosjet që Prokuroria Speciale i ka për krimet e luftës, është numër tepër i vogël, në mënyrë që të adresohen saktë dhe drejt. Në vitin 2021 kanë qenë 70 vende të lira në KPK, në vitin

2022 kanë qenë 97 vende të lira në sistemin prokurorial, në vitin 2023 ishin 87 vende të lira, dhe në vitin 2024 janë 87 vende të lira, prandaj është jashtëzakonisht e rëndësishme që sa më shpejt të rritet numri i prokurorëve specialë edhe duke pasur parasysh se kanë alokuar mjete për këtë, por ende ky numër është tepër i vogël.

Ardian Hajdaraj, tha se është e vërtetë që janë lejuar katër pozita, por ka qenë një sfidë vazhdimisht në sistemin tonë dhe nuk është e mundur që të rekrutohen drejtpërdrejt në Prokurorinë Speciale, por ata duhet të shkojnë përmes procedurave të avancimit. Një sfidë tjetër shumë e madhe, që e kanë pasur në sistemin prokurorial, është dorëheqja e prokurorëve serbë në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, 10 prokurorë serbë dhe 22 nga stafi mbështetës dhe kjo ishte ndër sfidat më të mëdha që e kanë përcjellë si sistem, por edhe Ministrinë e Drejtësisë.

Ministria ka qenë e njoftuar për këtë, dhe për shkak të këtyre vështirësive, është dashur dy herë të gjendet një zgjidhje urgjente dhe të dërgohen prokurorë shtesë atje, të bëjmë transferim të përkohshëm nga prokuroritë tjera dhe së fundmi kemi urdhëruar Kryeprokurorin e Shtetit, që t'i dërgojë atje për transfer të jashtëzakonshëm 3 prokurorë në Departamentin e Përgjithshëm dhe një për krime të rënda dhe për këtë e ka marrë vendimin kryeprokurori. Tha se vazhdimisht kanë bërë kërkesa të arsyeshme buxhetore dhe vitin e kaluar kanë bërë kërkesë të arsyeshme për 21 milionë euro, për numrin e nevojshëm që kanë paraparë me planin strategjik për zhvillimin e sistemit, që të shtohet numri edhe në Prokurorinë Speciale, mirëpo nuk është aprovuar, dhe janë aprovuar vetëm 15 milionë dhe tash janë të lejuara vetëm 964 pozita për staf administrativ dhe prokurorë, ndërsa në vitin 2024 janë kërkuar 147 pozita, mirëpo asnjëra nga to nuk është aprovuar, kështu që edhe kjo është një vështirësi, sepse po të merren parasysh gjithë këto probleme dhe nëse shtohet numri i prokurorëve, duhet të shtohet edhe stafi mbështetës, siç janë edhe bashkëpunëtorët, siç është paraparë me ligj dhe po ashtu edhe zyrtarët ligjorë. Janë kërkuar edhe 15 pozita për mbrojtës të viktimave, mirëpo ato pozita nuk janë lejuar tani për tani dhe po presim që me rishikim të buxhetit, të lejohen, sepse ka qenë një vendim edhe i ministres, që këto pozita të bëhen menjëherë.

Njoftoi se më 15 janar 2024, kanë shpallur konkursin për 28 pozita të lira, ku katër prej tyre kanë qenë të rezervuara për komunitetin serb dhe asnjë nga komuniteti serb nuk ka aplikuar.

Po ashtu, njoftoi se gjatë vitit 2023 janë avancuar 6 prokurorë të shtetit në Prokurorinë e Apelit, 2 prokurorë në Prokurorinë Speciale, 5 prokurorë në Departamentin për Krime të Rënda dhe Prokurorinë Themelore në Prishtinë, 1 prokuror në Departamentin për Krime të Rënda në Prizren, janë avancuar 2 prokurorë në Departamentin për Krime të Rënda, po ashtu në Prishtinë, me një konkurs tjetër, po ashtu është bërë avancimi i fundit me dy prokurorë në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. Ndërsa, gjatë vitit 2024, është avancuar një prokuror në Departamentin për Krime të Rënda në Ferizaj, një prokuror në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore në Prizren. Është shpallur konkursi dhe është në përfundim për 9 pozita të lira në Prokurorinë Speciale dhe pritet së shpejti të avancohen 9 prokurorë dhe është përgjegjësi e Prokurorisë Speciale, që t'i sistemojë nëpër departamente adekuate.

Kryetarja pyeti: Për momentin, sa prokurorë janë duke punuar në këtë fushë?

Ardian Hajdaraj, njoftoi se për momentin janë 3 prokurorë.

Ilir Morina, tha se veprimet e para që kanë bërë, si Prokurori Speciale, ka qenë identifikimi i problemeve, dhe si rezultat i kësaj, kanë nxjerrë një strategji që është propozuar me Këshillin Prokurorial dhe është miratuar në vitin 2019, pastaj është bërë themelimi i Departamentit të Veçantë dhe janë caktuar 4 prokurorë, që të punojnë në atë departament. Me daljen në pension të një prokuroreje, tani janë 3 prokurorë dhe janë në fazën e avancimit të prokurorëve dhe presin që njëri nga prokurorët e avancuar, të vijë në Departamentin për Krimet e Luftës, janë rekrutuar përkthyes, sepse përkthimi është identifikuar si një nga sfidat gjatë punës së tyre.

Ai, ndër të tjera, shtoi se lëndët vazhdimisht rriten dhe për çdo vit pranojnë lëndë të reja. Vetëm në vitin 2023, kanë kryer 23 lëndë nga Departamenti i Krimeve të Luftës, derisa prej vitit 2016-2019 kanë qenë vetëm 12 lëndë. Më tej, tha se kanë bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe kanë koordinuar bashkëpunimin me organizatat e ndryshme të shoqërisë civile, vendore dhe ndërkombëtare, sidomos ka qenë e theksuar te ato të veprave të dhunës seksuale, si krime lufte, dhe aktualisht Prokuroria Speciale ka rreth 50 raste aktive. Prej këtyre rasteve kanë ngritur 6 aktakuzë, për 3 raste kanë fillim zyrtar të hetimit, kurse rastet tjera janë ende në trajtim në procedurën para hetimore.

Si rezultat i bashkëpunimit me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, është nxjerrë një udhëzues për procedurat standarde të trajtimit të rasteve të dhunës seksuale, si krim lufte. Ky dokument zbatohet nga organizatat joqeveritare, që avokojnë për kategorinë e caktuar, nga Policia e Kosovës, nga Departamenti i Krimeve të Luftës.

Kryetarja pyeti: Sa kohë merr trajtimi i një lënde të tillë dhe sa persona punojnë për një lëndë?

Ilir Morina, tha se dhënia e një përgjigjeje të saktë është e vështirë. Vështirësitë janë të natyrës ligjore dhe përafërsisht kanë standardin ligjor, që përcakton Kodi i Procedurës, që janë tri vite në parim dhe as Gjykata Evropiane nuk ka mundur të caktojë se cili është standardi më korrekt për një afat të hetimit, për shkak të natyrës së të drejtave të njeriut, komplikimeve të rasteve etj.

Shtoi se në vitin 2021, ka filluar hetimin e rastit të Masakrës së Reçakut dhe është rast i ri. Komplexiteti është sepse ke mundësi për të hetuar dhe për të mbledhur prova në territorin e Kosovës. Por, gjithashtu, ka dy vende të burimit të provave, që është Serbia dhe që është Gjykata Ndërkombëtare e ish-Jugosllavisë, që është mekanizëm. Me këto dyja, që mund të sigurohen prova, nuk ka bashkëpunim, ndërsa për territorin e Kosovës, si çështje është e përfunduar, por ende nuk është gati të ngrihet aktakuzë, sepse i duhen prova të tjera, sepse një ndër pikat e Strategjisë, është përgjegjësia komanduese e kryerësve. Për këtë duhen dokumentet, për të vërtetuar qoftë pozitën hierarkike, qoftë të kryerësit, qoftë komunikimet e brendshme që i kanë pasur njësitet që kanë qenë në terren. Dhe, në mungesë të këtyre provave, është vështirë për t'ua dhënë një afat, pra për të thënë se kjo lëndë do të kryhet për një javë, një muaj apo një vit.

Fatmire Kollçaku, pyeti: Si qëndrojnë raportet me Komisionin Qeveritar për Verifikimin dhe Njohjen e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës, pasi që është një komision që disponon me të dhëna?

Ilir Morina, tha se me këtë Komision qeveritar kanë bashkëpunim shumë të mirë dhe sfida paraqitet kur viktimat deklaron se ka shkuar në komision dhe nuk iu ka njohur

statusi. Në anën tjetër, insiston të vijë në prokurori dhe të hapë rast dhe të hetojmë rastin. Rastet e tilla marrin shumë kohë që të trajtohen, për shkak të kompleksitetit të tyre.

Arjeta Fejza, tha se në takimin që kishin me organizatat që merren me çështjen e të drejtave të njeriut dhe organizatat që merren me viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, është adresuar çështja e zgjatjes së procesit që po e merr trajtimi i lëndëve dhe fakti që tani disa prej viktimave veç janë në moshë dhe po ndërrojnë edhe jetë dhe ende lëndët janë të paproceduara, ende nuk po fillojnë hetimet. Disa prej tyre, veç mund të janë raste aktive, megjithatë është shqetësuese që po zgjatet shumë ky proces.

Njoftoi se në takimin që kishin me përfaqësuesit e Këshillit Koordinues të Familjarëve të Personave të Zhdukur, kanë adresuar shqetësimin lidhur me aspektin e ngritjeve të aktakuzave për krimet që janë kryer gjatë luftës në Kosovë, prandaj ky takim ka qenë i domosdoshëm edhe për të parë se si të angazhohemi tutje.

Po ashtu, e vlerëson gatishmërinë e Ministrisë së Drejtësisë, për ta ndihmuar Këshillin Prokurorial, qoftë me buxhet, qoftë në aspektet e tjera, për të shtuar numrin e prokurorëve dhe për t'i dhënë prioritet kësaj çështjeje. Si komision, përkrahin çdo nismë pozitive.

Labinotë Demi- Murtezi, pyeti: Cilat janë procedurat e avancimit, të cilat po pengojnë në ngritjen e aktakuzave dhe ecjen përpara të çështjeve?

Sa i përket kërkesave buxhetore nga KPK, po insistohet për buxhet shtesë, ndërsa ministrja tha se është ndarë buxhet shtesë prej Ministrisë së Drejtësisë. Po ashtu, tha se rritja e numrit për 5 prokurorë, për këtë periudhën e shkurtër, që është proklamuar dhe rritjes së numrit të prokurorëve të tjerë, në këtë drejtim, mund të avancojë ngritjen e aktakuzave. Rrjedhimisht, pritjen e rezultateve konkrete, sepse njerëzit po vdesin, dëshmitë po humbin. Krimet nuk vjetrohen, por dëshmitë po humbin, njerëzve po u humbet durimi, ka dëshpërime totale gjithandej, duhet të bëhet diçka konkrete, sepse janë dy dallime të mëdha. Vende të lira janë e ka kërkesë për vende të lira të punës, ndarje e buxhetit, e kërkesë për buxhet shtesë. Po ashtu, thuhet se ka bashkëpunim me OJQ-të e ka vërejtje prej OJQ-ve pa mbarim për punë konkrete, mirëpo shpreson në bashkëpunim për konkretizim të çështjeve që janë aq të ndjeshme dhe serioze.

Albulena Haxhiu, tha se në kohën kur krimet e luftës kanë qenë në kompetencë të UNMIK-ut dhe EULEX-it, nuk ka pasur veprime serioze. Pra, këtë ua ka thënë publikisht edhe përfaqësuesve të këtyre organizatave. Po të kishte trajtim serioz, nuk do të ishim në situatën ku shumë pak kriminelë të luftës janë të dënuar. Tha se konsideron se është jashtëzakonisht e rëndësishme, që të mos ndalemi në përpjekjen tonë për drejtësi për krimet e luftës. Gjithçka që është varur nga Qeveria, e kanë adresuar me prioritet. Gjithashtu, tha se realisht, Qeveria i lejon pozitat për institucionet, në këtë rast edhe për KPK-në, por që nuk mund të tregojë se në çfarë profesione, por është Këshilli Prokurorial që pastaj i adreson aty ku ka nevojë, edhe nëse do të ketë plotësim-ndryshim të buxhetit do të avokojmë, si dhe ka qenë në gjendje që pozitat e lira të Ministrisë së Drejtësisë, të kalojnë sërish në KPK, për numrin e mbrojtësve të viktimave, por nuk mjafton vetëm një vullnet i institucionit.

Ardian Hajdaraj, tha se nga KPK është kërkuar buxhet prej 21 milionëve dhe janë aprovuar vetëm 15 milionë. Nga analiza që është bërë, del se numri i mjaftueshëm për prokurorë, në të gjitha departamentet, përfshirë edhe Prokurorinë Speciale, është 240

prokurorë. Tash janë të lejuara vetëm 204 pozita, por për shkak të problemit që pensionohen vazhdimisht, tani kanë mbetur 173, duke përfshirë edhe 10 prokurorë serbë, që kanë dhënë dorëheqje. Këto dorëheqje nuk janë miratuar, ende janë duke u shqyrtuar në Këshill, sepse Këshilli Prokurorial, por edhe Këshilli Gjyqësor nuk i ka aprovuar ende ato dorëheqje, sepse konsiderojnë se është çështje politike.

Labinotë Demi- Murtezi, pyeti: Sipas ligjeve në fuqi, për sa kohë iu ruhet vendi prokurorëve të dorëhequr, a ka afat ligjor, për sa duhet shpallur ato vende të lira?

Ardian Hajdaraj, tha se ato janë bërë me marrëveshje ndërkombëtare.

Kryetarja pyeti: Prokurorët e dorëhequr, a janë ende duke marrë paga?

Ardian Hajdaraj, tha se çështja e pagave për ata prokurorë është pezulluar, nuk janë në sistem dhe nuk janë duke marrë paga. KPK dhe KGJK, së bashku me ministren e Drejtësisë, do t'i diskutojnë këto çështje, por afat ligjor, lidhur me këtë çështje, nuk ka.

Fatmire Kollçaku, tha se u kuptua që për nevojat buxhetore, një shumë e konsiderueshme e mjeteve, qenka ndarë. Pushtetet janë të ndara dhe nuk duhet të shikohemi karshi njëri-tjetrit, si kundërshtarë, por shumë bashkëpunues. Tema për të cilën po diskutojmë, është shumë e ndjeshme dhe të gjithë pyesin, se a do të vijë ajo drejtësi. Ministrja është shumë e angazhuar, lidhur me këtë temë, ndërsa si deputetë, janë ndërmjetësues mes KPK-së dhe Qeverisë dhe janë që t'i mbështesin kërkesat e KPK-së, sepse pozicioni i prokurorëve është mjaft i rëndësishëm dhe i vështirë. Pra, duhet t'i sigurohen kushtet, që të punojnë në mënyrë të pavarur dhe profesionale.

Ajo kërkoi nga ministrja e Drejtësisë, që të përditësohet doracaku për dhënien e provimit të jurisprudencës, pasi që ka vërejtje nga kandidatët, sepse ka pasur ndryshime të ligjeve dhe mos të ketë ngatërresa në referenca të neneve të ligjeve, që tashmë veç kanë ndryshuar.

Illir Morina, tha se në një konferencë, OJQ-të, si vendore e ato ndërkombëtare, flisnin për një databazë që iu referohet krimeve të luftës, që asnjëra nuk merret me të vërtetuarit e drejtësisë. Atë databazë, tha se nuk e kanë këta, një databazë, që i ka të gjitha të dhënat, e ka UNMIK-u dhe EULEX-i, nuk e kanë transferuar dhe kjo ka mbetur çështje e diskutueshme.

Pra, një databazë që e kanë të gjitha OJQ-të, me lista, por tha se këta nuk e kanë, prandaj thërret për bashkëpunim që, si prokurorë, ta bëjnë më lehtë punën e tyre.

Në fund, shpërndau për disa anëtarë të Komisionit disa raporte të punës, e edhe një raport me krimet e luftës, që Prokuroria Speciale e ka bërë.

Albulena Haxhiu, shtoi se është e vërtetë që e kanë adresuar disa herë kërkesën që databazën t'ua kalojnë institucioneve, por thjesht nuk përgjigjen, shprehimisht duke thënë se do të shohim, do të angazhohemi, do ta adresojmë, por deri tani nuk e kemi databazën që është e nivelit të lartë në kuptimin që është shumë e avancuar dhe do t'i ndihmonte Prokurorisë Speciale.

Kryetarja shpreson që të gjitha këto punë pozitive që u përmenden, që janë në proces, do të përmbillen shumë shpejt me sukses, si ato të avancimit e rekrutimit në sistemin prokurorial.

4. Shqyrtimi i propozim-raportit me rekomandime lidhur me raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2022

Kryetarja konstatoi se me pëlqimin e anëtarëve të Komisionit, kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për mbledhjen e radhës.

5. Të ndryshme

Kryetarja konstatoi se Komisioni, në mbledhjen e radhës, do të ftojë kryesuesin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së dhe drejtorin ekzekutiv të AKP-së, lidhur me peticionin e punëtorëve të AKP-së.

Mbledhja përfundoi në orën 14:05.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Duda BALJE,

Kryetare e Komisionit